



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.177 dt.27.11.1997

Në mbledhjen e datës 27.11.1997, Këshilli Bashkiak i qytetit të Tiranës, në bazë të Ligjit Nr.7756, dt.11.10.1993 “Për shtypin” si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 “Mbi organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”

VENDOSI

1. Të miratojë ribotimin e gazetës së Bashkisë së Tiranës si person juridik me titull “**GAZETA BASHKIAKE**”, organ periodik i Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak të Tiranës.
2. Të miratojë përbërjen e Këshillit Botues, të përbërë nga 9 anëtarë të dalë nga propozimet e Këshilltarëve, duke ruajtur raportet e përfaqësimit të partive politike në Këshillin Bashkiak të Tiranës. Ky Këshill Botues përbëhet nga :

1.BURON KACELI

2.RAMIZ XHANI

3.ZERINA KUKE

4.LULZIM QINAMI

5.ARDIAN HACI

6.MAKSIM HAVIARI

7.FATRI SINANI

8.AFERDITA STEFANI

9.LUAN SHAHOLLARI

3. Të emërojë Z.Sulejman Mato, kryeredaktor të kësaj Gazete.

4. Të miratojë fondin prej 300.000 (treqindmijë) lekë, i cili do të depozitohet në një numër llogarie të veçantë dhe do të shërbejë për përballimin e shpenzimeve të botimit të kësaj gazete.
Veprimtaria e Gazetës do t'i nënshtrohet kontrollit të Drejtorisë së Financave pranë Bashkisë së Tiranës dhe Këshillit Bashkiak. Kjo veprimtari do të zhvillohet konform ligjeve në fuqi.
Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria Juridike për regjistrimin sipas ligjeve në fuqi.
Redaksia të hartojë rregulloret e funksionimit të cilat do të miratohen nga Këshilli Botues.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI